



REPUBLIKA E SHQIPERISE



MINISTRIA PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME



MINISTRI I SHTETIT PËR DIASPORËN

Nr. 7561 Prot.
Tiranë, më 07/07/2020

Nr.3428 Prot.
Tiranë, më 07/07/2020

MARRËVESHJE

NDËRMJET

MINISTRISË PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME

DHE MINISTRISË SË SHTETIT PËR DIASPORËN

“Për caktimin e oficerëve koordinues për çështjet e diasporës shqiptare në konsullatat shqiptare në Itali dhe Greqi”

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, e përfaqësuar nga Ministri z. **Gent Cakaj** dhe Ministria e Shtetit për Diasporën, e përfaqësuar nga Ministri z. **Pandeli Majko**, në zbatim të Vendimit Nr. 780 Datë 6.11.2019 të Këshillit të Ministrave “Për caktimin e oficerëve koordinues për çështjet e diasporës shqiptare në konsullatat shqiptare në Itali dhe Greqi” bien dakord për nënshkrimin e marrëveshjes si vijon:

Neni 1 **Qëllimi**

Kjo marrëveshje ka për qëllim të formalizojë rregullat për funksionimin e Oficerëve koordinues për çështjet e diasporës shqiptare, që kanë të bëjnë me çështjet e arsimit, të drejtësisë dhe të nxitjes së investimeve, në Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Republikën e Italisë, Konsullatën e Përgjithshme të Republikës së Shqipërisë në Milano, Itali, në Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Greqi, në Konsullatën e Përgjithshme të Republikës së Shqipërisë në Selanik, Greqi.

Neni 2 **Baza ligjore**

Mbështetur në nenin 31 pika 2 të Ligjit 23/2015 “Për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë” dhe pikës 2.1 të Vendimit Nr. 780 Datë 6.11.2019 të Këshillit të Ministrave “Për caktimin e oficerëve koordinues për çështjet e diasporës shqiptare në konsullatat shqiptare në Itali dhe Greqi”. Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 345, datë 29.04.2020 “ Për procedurat për emërimin dhe trajtimin financiar të nëpunësve të emëruar nga institucionet e tjera në misionet diplomatike të RSH”, bien dakord si më poshtë:

Neni 3 **Grada e emërimit**

Oficerët koordinues të diasporës do të kenë gradë emërimi Sekretar i Parë.

Neni 4 **Detyrimet e Ministrisë për Evropën dhe Punëve të Jashtme**

1. Akrediton oficerët koordinues në ambasadën dhe konsullatat në Itali dhe Greqi, në zbatim të Vendimit Nr. 780 Datë 6.11.2019 të Këshillit të Ministrave “Për caktimin e oficerëve koordinues për çështjet e diasporës shqiptare në konsullatat shqiptare në Itali dhe Greqi”.
2. Krijimin e të gjitha lehtësirave për funksionimin e financave për Oficerët koordinues të MSHD, nëpërmjet ambasadave dhe konsullatave, në Itali dhe Greqi.
3. Miratimin e procedurave konkurruese që do të kryejnë ambasadat dhe konsullatat në Itali dhe Greqi edhe për shpenzimet e Oficerëve koordinues në shërbimin e tyre.
4. Marrjen e masave në përputhje me Konventën e Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike (dhe ligjin për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë për përfitimin nga katër oficerët koordinues të MSHD-së, e të gjitha të drejtave që gëzojnë punonjësit e përfaqësive diplomatike të Republikës së Shqipërisë në shtetet e huaja, sikurse edhe detyrimet që rrjedhin nga ky status.
5. Lëvrimin në llogaritë personale të secilit oficer koordinues përfaqësues të Përfaqësisë së Ministrisë së Shtetit dhe Diasporës, të pagës mujore dhe të gjitha shtesave që i takojnë pozicionit, sipas legjislacionit në fuqi.
6. Kontraktimin e shërbimit për qiramarrjen e banesave për secilin përfaqësues dhe ambientit për zyra, ndjekjen e procedurave të konkurrimit dhe marrjes së miratimit nga MEPJ.

7. Lidhjen e kontratave për shpenzimet e sigurimit të detyrueshëm shëndetësor, si dhe të gjitha shpenzimet që kanë të bëjnë me funksionimin e zyrës së Oficerëve koordinues të MSHD-së, duke përfshirë edhe pajisjet e zyrës.
8. Shpenzimet e përcaktuara në pikat 5, 6 dhe 7, të këtij neni, për vitin 2020 do të përballohen nga buxheti i Agjencisë Kombëtare të Diasporës në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.445 “Për një shtesë në Vendimin Nr.780 Datë 6.11.2019, të Këshillit të Ministrave “Për caktimin e oficerëve koordinues për çështjet e diasporës shqiptare në konsullatat shqiptare në Itali dhe Greqi” datë 03.06.2020.
9. Ndjekjen e procedurave për menaxhimin e fondeve të akorduara, sipas parashikimeve në ligj dhe bërjen transparente të shpenzimeve mujore Ministrisë së Shtetit dhe Diasporës, sipas detajeve të përcaktuara dhe zërave kryesorë të shpenzimeve, të përcaktuara.

Neni 5

Detyrimet e Ministrisë së Shtetit dhe Diasporës

1. Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme në përputhje me pikën 4 të Vendimit Nr. 780, Datë 6.11.2019 të Këshillit të Ministrave “Për caktimin e oficerëve koordinues për çështjet e diasporës shqiptare në konsullatat shqiptare në Itali dhe Greqi” merr përsipër mbulimin e shpenzimeve të ushtrimit të funksioneve oficerët koordinues për çështjet e diasporës shqiptare. Përfundimisht, për vitin 2020, efektet financiare të Vendimit Nr. 445, Datë 3.6.2020, “Për një shtesë në Vendimin Nr. 780, Datë 6.11.2019 të Këshillit të Ministrave “Për caktimin e oficerëve koordinues për Çështjet e Diasporës Shqiptare në Konsullatat Shqiptare në Itali dhe Greqi””, të Këshillit të Ministrave, do të përballohen nga buxheti i miratuar për Agjencinë Kombëtare të Diasporës.
2. Të lëvrojë për llogari të ambasadave dhe konsullatave, fondin e nevojshëm vjetor për mbulimin e shpenzimeve të ushtrimit të funksioneve të katër oficerëve koordinues përfaqësues të MSHD-së, në Itali dhe Greqi.
3. Të kryejë propozimin për emërim dhe të përcaktojë fillimin e marrëdhënieve të punës.
4. Të orientojë, ndjekë dhe mbikëqyrë detyrat e Oficerëve koordinues të Përfaqësive.
5. Të mbajë marrëdhënie, në mënyrë mujore, me Nëpunësin Zbatues të përfaqësimit diplomatike në Itali dhe Greqi, me qëllim evidentimin e shpenzimeve të kryera, për Oficerët koordinues e Ministrisë së Shtetit dhe Diasporës.

Neni 6

Të Drejtat e Oficerëve koordinues

1. Oficerët koordinues gjatë qëndrimit të tyre në konsullata gëzojnë të njëjtin status me diplomatët.
2. Oficerët koordinues e ushtrojnë funksionin e tyre për një afat 3 vjeçar (me të drejtë rinovimi jo më shumë se një herë).
3. Me mbarimi e misionit të Oficerët koordinues, kanë të drejtë që të kërkojnë zbatimin e kontratave që kanë lidhur me Ministrin e Shtetit për Diasporën, me përjashtim të rasteve të përmendura në nenin 10 dhe nenin 13 të kësaj marrëveshjeje.

Neni 7

Detyrat e Oficerëve koordinues

Në realizimin e funksioneve të tyre oficerët koordinues kanë detyrat e mëposhtme:

1. Zhvillimi i marrëdhënieve me komunitetet shqiptare në shtetin pritës në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Diasporës dhe krijimin e regjistrave elektronik për diasporën.

2. Identifikimi i nevojave për arsimimin dhe komunikimi me mësuesit e programeve plotësuese të gjuhës e të kulturës shqiptare në bashkëpunim me Qendrën e Botimit të Diasporës;
3. Nxitja dhe organizimi i bizneseve shqiptare në vendin pritës në bashkëpunim me Dhomën e Biznesit të Diasporës;
4. Identifikimi dhe asistimi i shtetasve shqiptarë, të cilët vuajnë dënimin me heqje të lirisë në shtetin pritës në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për drejtësinë.

Neni 8

Detyrimet e Oficerëve koordinues

1. Oficerët koordinues mbajnë përgjegjësi të plotë për ligjshmërinë e çdo veprimi apo mosveprimi të tij, gjatë ushtrimit të detyrës.
2. Oficerët koordinues kanë detyrimin të veprojnë në përputhje me urdhrat e marrë nga eprorët hierarkikë, sipas ligjit dhe rregullave të brendshme.
3. Në se oficerët koordinues kanë dyshime për paligjshmërinë e urdhrat të eprorit, ai nuk e zbaton urdhrin, por informon pa vonesë eprorin e personit që ka dhënë urdhrin dhe kërkon konfirmimin e tij me shkrim.
4. Oficerët koordinues kanë detyrimin ta zbatojë urdhrin me shkrim me përjashtim të rastit kur zbatimi i tij përbën vepër penale.
5. Oficerët koordinues kanë detyrimin të ushtrojnë detyrën e tij me transparencë dhe të sigurojnë për publikun e gjerë dhe palët çdo informacion të nevojshëm, me përjashtim të rasteve, kur ai është klasifikuar sekret shtetëror sipas ligjit.
6. Oficerët koordinues nuk duhet ta përdorin informacionin e mbledhur gjatë ushtrimit të detyrës për qëllime të tjera, jashtë atyre të përcaktuara me ligj. Ata kanë detyrimin të sigurojnë mbrojtjen dhe mospërhapjen e të dhënave vetjake dhe atyre që lidhen me veprimtarinë tregtare apo profesionale të personave, të mbrojtura sipas ligjit dhe me të cilat njihet gjatë ushtrimit të detyrës.

Neni 9

Varësia dhe Komunikimi

1. Gjatë kohës së qëndrimit në misionin diplomatik të oficerëve koordinues për çështjet e diasporës shqiptare në ambasadat dhe konsullatat shqiptare në Itali dhe Greqi konsiderohen anëtar të shërbimit të jashtëm. Eprori i tyre direkt është Titullari i Përfaqësisë Diplomatike.
2. Oficerët koordinues për çështjet e diasporës shqiptare në ambasadat dhe konsullatat shqiptare në Itali dhe Greqi do të ushtrojnë funksionin e tyre në bazë të detyrave të marra nga Titullari i Përfaqësisë, si dhe nga Ministrit përgjegjës për Diasporën. Ata raportojnë njëkohësisht tek Ministria e Punëve të Jashtme dhe tek Ministri përgjegjës për diasporën.

Neni 10

Masat disiplinore

Çdo anashkalim i detyrimeve të kësaj marrëveshjeje nga oficerët koordinues për çështjet e diasporës shqiptare në ambasadat dhe konsullatat shqiptare në Itali dhe Greqi përbën shkelje të disiplinës. Vlerësimi i shkeljes vlerësohet, rast pas rasti, nga Titullari i Përfaqësisë. Ai, në vlerësimin e tyre, bën propozimin Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme për marrjen e masave administrative deri në lirim nga detyra. Lirimi nga detyra, kryhet nga Ministri përgjegjës për diasporën me propozim të Ministrit përgjegjës për punët e jashtme.

Neni 11

Largimi para kohe nga detyra

Në rastin e mosplotësimit të detyrave të përcaktuara në këtë marrëveshje nga oficerët koordinues për çështjet e diasporës shqiptare në ambasadat dhe konsullatat shqiptare në Itali dhe Greqi, ata largohen nga detyra kundrejt njoftimit me shkrim tre muaj përpara hyrjes në fuqi të zbatimit të saj.

Neni 12

Mbarimi i misionit

Periudha e qëndrimit në shërbim në misionin diplomatik është me një afat 3 (tre) vjeçar, me të drejtë rinovimi, vetëm një herë. Ministri përgjegjës për diasporën është përgjegjës për zbatimin e kontratave individuale që lidhin me Oficerët koordinues.

Neni 13

Ndryshimi i Marrëveshjes

Marrëveshja mund të ndryshohet vetëm me miratimin e ndërsjellë me shkrim të palëve.

Neni 14

Përfundimi i Marrëveshjes

Kjo marrëveshje mund të përfundojë me shfuqizimin e Vendimit Nr. 780 Datë 6.11.2019 të Këshillit të Ministrave "Për caktimin e oficerëve koordinues për çështjet e diasporës shqiptare në konsullatat shqiptare në Itali dhe Greqi".

Neni 15

Hyrja në fuqi

Kjo marrëveshje hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij nga përfaqësuesit e palëve. Marrëveshja hartohet në gjuhën shqipe, përgatitet dhe nënshkruhet në 4 (katër) kopje origjinale, dy prej të cilave depozitohen në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, dy të tjera pranë Ministrit të Shtetit për Diasporën.

**MINISTRI NË DETYRË PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME**

GENT CAKAJ

MINISTRI I SHTETIT PËR DIASPORËN

PANDELI MAJKO